



**ILLYRIAN GUARD SH.A.**

Nr. 820/18 Prot.

Datë 27.06 2023

**Lënda:** Mbi dërgimin e vendimit për Drejtorinë Rrajonale OSSH-sha, Fier

**Drejtoria Rrajonale OSSH-sha, Fier**

*Adresa: Rr Enriko Veizi, Lagjia 1 Maj, Fier*

**FIER**

**Për dijëni:** **Agjencisë së Prokurimit Publik**

*Adresa: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Këshilli i Ministrave,*

**TIRANË**

Bashkëlidhur ju dërgojmë:

Vendimin e Shoqërisë "Illyrian Guard" ShA për subjektin:  
Drejtoria Rrajonale OSSH-sha, Fier.


Duke Ju falënderuar për bashkëpunimin,

**ADMINISTRATORI**

**Robert LILI**

**Në mungesë dhe me urdher**

**Shpresa BELLO**



Konc Print: E Frashni  
Miratoi: G Tarka  
Q Abedini  
L Pula



**ILLYRIAN GUARD SH.A.**

Nr. 820/7 Prot.

Tiranë, më 27.06/2023

**Vendim**

I mbajtur sot, në datë 27.06.2023, për shqyrtimin e kërkesës së subjektit publik Drejtoria Rrajonale OSSH-sha, Fier, Rr Enriko Veizi, Lagjia 1 Maj, Fier, për përfitimin e shërbimit të sigurisë 1.3.A nga shoqëria "Illyrian Guard" ShA, nga Komisioni i ngritur me urdhër nga Komisioni i ngritur me urdhër nr. 1529, datë 08.11.2022, "Për ngritjen e komisionit për shqyrtimin e kërkesës së subjektive publike dhe private drejtuar shoqërisë "Illyrian Guard" ShA për shërbimin e sigurisë 1.3.A", e pjesëmarrjen e:

- 1.1. Liridon Pula, Drejtor i Drejtorisë Tregëtare , Kryetar;
- 1.2. Qamil Abedin, Drejtor Teknik 1.3.A., Anëtar;
- 1.3. Gentjan Tarka Drejtor i Drejtorisë së Teknologjisë dhe informacionit, Anëtarë;

Komisioni, pasi u njoh me kërkesën e subjektit Drejtoria Rrajonale OSSH-sha, Fier nr. 820 prot, datë 08.05.2023 "Mbi shërbimin e ruajtjes dhe sigurisë fizike të objekteve" dhe praktikën e ndjekur lidhur me korrespondencën negociuese të mbajtur mes dy palëve, konkretisht:

1. Relacionin e Sigurisë nr. 820/1 prot, datë 22.05.2023 "Relacion mbi përfundimin e analizës së elementëve të sigurisë në objektet të Drejtorisë Rrajonale të OSSH+FSHU Fier"
2. Shkresa e Shoqërisë "Illyrian Guard" ShA nr. 820/2, datë 23.05.2023 me lëndë "Kthim përgjigje shkresës nr.290 prot, datë 05.05.2023",
3. Shkresën e Drejtorisë Rrajonale OSSH-sha, Fier nr. 820/3, datë 30.05.2023 me lëndë "Kthim Përgjigje,,,".
4. Shkresa e Shoqërisë "Illyrian Guard" ShA nr. 820/4, datë 02.06.2023 me lëndë "Kthim përgjigje shkresës nr.290/2 prot, datë 25.05.2023...".
5. Shkresën e Drejtorisë Rrajonale OSSH-sha, Fier nr. 820/5, datë 19.06.2023 me lëndë "Kthim Përgjigje shkresës nr.820/4 prot, datë 02.06.2023....".

**I. VLERËSIM PARAPRAK**



## ILLYRIAN GUARD SH.A.

Komisioni paraprakisht vlerëson në praktikën e Shoqërisë “Illyrian Guard” ShA, si më poshtë:

### A. Në aspektin ligjor

1. Subjekti, bazuar në **Ligjin 75/2014**, datë 10.07.2014 “Për shërbimin privat të sigurisë fizike”, dhe **VKM nr.177**, datë 04.04.2019 “Për krijimin dhe funksionimin e Shoqërisë “Illyrian Guard” ShA dhe për përcaktimin e autoritetit publik, që përfaqëson shtetin si pronar të aksioneve të kësaj shoqërie” i është drejtuar shoqërisë “ Illyrian Guard” Sh.A me kërkesën nr. 820 prot, datë 08.05.2023 “Mbi shërbimin e ruajtjes dhe sigurisë fizike të objekteve ” përmes të cilës kërkon ofrimin e shërbimit të sigurisë në Fier dhe Vlorë si dhe FSHU Fier, Ballsh, Patos, Roskovec, Vlorë, Orikum dhe Himarë si më poshtë:

- Shërbimi i ruajtjes dhe sigurisë fizike me 25 vëndroje. Në këto vëndroje shërbimi do të kryhet i kombinuar me roje fikse 24 orë, 12 orë, 8 orë dhe sistem vëzhgimi dhe alarmi sipas tabelës në shkresën e sipërcituar,
- Shërbimi i shoqërimit të vlerave monetare me ekskortë të përbërë nga dy punonjës, njëri prej të cilëve shofer i mjetit të blinduar i certifikuar nga DVP.
- Shërbimi i ruajtjes me sistem alarmi dhe vëzhgimi në 19 objekte, pa përcaktuar numrin e sistemeve.
- Fondi i planifikuar për periudhën 12 muaj për shërbimin e sigurisë fizike të objekteve është **89,555,508 lekë pa TVSH**.
- Fondi i planifikuar për periudhën 12 muaj për shërbimin e sigurisë fizike të objekteve dhe shoqërimin e vlrave monetare është **100,159,140 lekë** pa TVSH.
- Shoqëria “Illyrian Guard” ShA nëpërmjet shkresës nr. 820/2, datë 23.05.2023 me lëndë “Kthim përgjigje shkresës nr.290 prot, datë 05.05.2023”, duke u mbështetur në relacionin e sigurisë nr. 820/1 prot, datë 25.05.2023 “Relacion mbi përfundimin e analizës së elementëve të sigurisë në objektet të OSSH+FSHU Fier” ka paraqitur përlllogaritjen financiare për shërbimin e ruajtjes dhe sigurisë fizike me me **79.06 punojës shërbimi** dhe **25 sisteme elektronike**, fondi i nevojshëm është në vlerën **113,239,099 lek** pa TVSH për 12 muaj.



## ILLYRIAN GUARD SH.A.

6. Shoqëria “Illyrian Guard” ShA po përmes kësaj shkrese ka kërkuar ndarje të fondit të shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike nga fondi i shoqërimit të vlerave monetare dhe marrje të masave për ndryshim të fondit.

- Subjekti përmes shkresës nr. 820/3, datë 30.05.2023 me lëndë “kthim përgjigje”, subjekti ka bërë ndarje të fondit si më poshtë:
- Fondi për ruajtje dhe sistem alarmi është **89,555,508 lekë pa TVSH**.
- Fondi për shoqërim të vlerave monetare është **10,636,258.7 lekë pa TVSH**.

7. Shoqëria “Illyrian Guard” ShA përmes shkresës nr. 820/4, datë 08.06.2023 me lëndë “Kthim Përgjigje shkresës nr.290/2 prot, datë 25.05.2023”, ka vënë në ndijeni subjektin se me fondin në dispozicion nuk mund të mbulohet shërbimi me 79,06 punonjës dhe 25 sisteme vëzhgimi dhe sinjalizimi dhe ka ofruar 2 variante shërbimi si më poshtë :

**Varianti I:** me 9 sisteme vëzhgimi dhe sinjalizimi dhe 79,06 punonjës shërbimi,

**Varianti II:** me 25 sisteme vëzhgimi dhe sinjalizimi dhe 79,06, punonjës shërbimi për 9 muaj e 14.9 ditë në shumën **9,436,592**.

Subjekti është vënë në dijeni se Shoqëria “Illyrian Guard” ShA nuk mund të ofrojë shërbimin 1.3.B.

8. Subjekti nëpërmjet shkresës nr. 820/5, datë 19.06.2023 me lëndë “Kthim Përgjigje shkresës nr.820/4 prot, datë 02.06.2023....” ka bërë me dijeni se fondi i tyre për shërbimin 1.3.A është i pa negociueshëm për 12 muaj .

Asnjë prej akteve ligjore në fuqi për sa i përket fushës së ruajtjes dhe sigurisë fizike nuk përcaktojnë se kush duhet të jetë autoriteti që vendos mbi sasinë e numrit të punonjësve të shërbimit të sigurisë dhe/ose numrin e sistemeve elektronike të vëzhgimit dhe të alarmit për subjektet publike. Në këto kushte, kur dy subjekte, njëri ofruet shërbimi potencial, tjetri përfitues potencial i shërbimit të sigurisë, janë në negociim të kushteve dhe kriterëve të lidhjes së një kontrate, bazuar në **Kodin Civil, nenin 660 e vijues**, numri i punonjësve të sigurisë dhe sistemeve do të ngelej në dakortësinë e plotë të dy palëve.

### B. Në aspektin teknik

9. Specialistët e Sigurisë së Shoqërisë “Illyrian Guard” ShA, nëpërmjet Relacionin e sigurisë nr. 820/1 prot, datë 22.05.2023 “Relacion mbi përfundimin e analizës së elementëve të sigurisë në objektet të OSSH+FSHU Fier dhe Vlore, drejtuar



## ILLYRIAN GUARD SH.A.

Administratorit të Shoqërisë “Illyrian Guard” ShA, kanë përcaktuar numrin e vëndrojeve dhe sistemeve elektronike të vëzhgimit, bazuar në analizën e tyre në terren. Subjektit i është vënë në dispozicion përmes shkresës së Shoqërisë “Illyrian Guard” ShA nr. 820/2, datë 23.05.2023 me lëndë “Kthim përgjigje shkresës nr.290 prot, datë 05.05.2023”.

### C. Në aspektin financiar

1. Lidhur me mënyrën e ruajtjes dhe sigurisë fizike të objekteve financiarisht paraqiten opsionet si më poshtë:
2. **Varianti I:** me 9 sisteme vëzhgimi dhe sinjalizimi dhe 79,06 punonjës shërbimi,
3. **Varianti II:** me 25 sisteme vëzhgimi dhe sinjalizimi dhe 79.06, punonjës shërbimi për 9 muaj e 14.9 ditë në shumën **9,436,592**.
  - Nëse do ofrohet shërbimi me 79,06 punonjës shërbimi dhe 25 sisteme elektronike vëzhgimi dhe alarmi, me fond në dispozicion **89,555,508 lekë pa TVSH**, do të shkaktonte **një efekt negativ financiar** për Shoqërinë “Illyrian Guard” ShA në vlerën **113,239,099 - 89,555,508 = 23,683,591 lekë pa TVSH**.
  - Kjo nënkupton që kontrata e lidhur me subjektin në fjalë, do të konsiderohej **kontratë negative**, pasi pjesërisht do duhej të mbulohej nga të ardhurat e Shoqërisë “Illyrian Guard” ShA. Duke marrë në konsideratë Raportin Final të Drejtorisë së Auditit të Ministrisë të Brendshme nr. 991/6 datë 21.10.2021 “Mbi Auditimin e kombinuar përputhshmërie dhe financiar për periudhën Prill 2019 – 30.04.2021”, Rekomandimi nr.3, shuma prej **23,683,591 lekë** me TVSH do të konsiderohej “e ardhur e munguar” për Shoqërinë “Illyrian Guard” ShA.

### II. KONKLUZIONE

4. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar gjatë procedurës së verifikimit të kushteve në aspektin ligjor, teknik dhe financiar, Komisioni vlerëson se procedura e ndjekur në këtë rast është në përputhje me aktet ligjore në fuqi.  
Praktika në fjalë, **nuk përmbush kushtin financiar** pasi fondi që disponon subjekti është i pamjaftueshëm për numrin e kërkuar të punonjësve të shërbimit dhe sistemeve të vëzhgimit dhe alarmit. Shoqëria “Illyrian Guard” ShA si një shoqëri tregtare me qëllime fitime dhe garantuese e sigurisë, i ka ezauruar të gjitha etapat negociuese si më poshtë :
5. **Varianti I:** me 9 sisteme vëzhgimi dhe sinjalizimi dhe 79.06 punonjës shërbimi,



## ILLYRIAN GUARD SH.A.

**Varianti II:** me 25 sisteme vëzhgimi dhe sinjalizimi dhe 79.06, punonjës shërbimi për 9 muaj e 14.9 ditë në shumën **9,436,592**, të cilat nuk u paruan nga subjekti dhe ka vënë në diejti së aktualisht nuk mund të ofrojë shërbimin 1.3.B.

6. Duke marrë parasysh që subjekti e ka refuzuar ofertën e Shoqërisë “Illyrian Guard” ShA, si dhe mbështetur në:
- Ligjin Nr. 44/2015 “Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë”
  - Ligjin Nr.7850, datë 29.7.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 660 e vijues;
  - Ligjin Nr.9901, datë 14.4.2008 “Tregtarët dhe shoqëritë tregtare”;
  - Ligjin Nr. 75/2014, datë 10.07.2014 “Për shërbimin privat të sigurisë fizike”,
  - Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar,
  - VKM nr.177, datë 04.04.2019 “Për krijimin dhe funksionimin e Shoqërisë “Illyrian Guard” ShA dhe për përcaktimin e autoritetit publik, që përfaqëson shtetin si pronar të aksioneve të kësaj shoqërie”,
  - VKM-në nr. 275, datë 02.05.2019 “Për përcaktimin e kriterëve dhe kategorizimin e objekteve shtetërore, sipas mënyrës së ruajtjes e të sigurimit fizik të tyre”,
  - Udhëzimin e Ministrit të Brendshëm nr. 130, datë 5.3.2018 “Për funksionimin e shërbimit privat të sigurisë fizike”
  - Udhëzimin e Përbashkët të Ministrit të Brendshëm dhe Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 407/1, datë 14.6.2019 “Për mënyrën e përlllogaritjes së tarifave të shërbimeve specifike, që u ofrohen subjekteve publike, nga Shoqëria “Illyrian Guard” ShA Statutin e Shoqërisë “Illyrian Guard” ShA,
  - Rregulloren e Brendshme të Shoqërisë “Illyrian Guard” ShA,
  - Raporti Final i Drejtorisë së Auditit të Ministrisë të Brendshme nr. 991/6 datë 21.10.2021 “Mbi Auditimin e kombinuar përputhshmërie dhe financiar për periudhën Prill 2019 – 30.04.2021”, Rekomandimi nr.3;
  - Kërkesën e subjektit Drejtorisë Rrajonale OSSH-sha, Fier nr. 820 prot, datë 08.05.2023 “Mbi shërbimin e ruajtjes dhe sigurisë fizike të objekteve”
  - Relacionin e Sigurisë nr. 820/1 prot, datë 22.05.2023 “Relacion mbi përfundimin e analizës së elementëve të sigurisë në objektet të Drejtorisë Rajonale të OSSH+FSHU Fier”



### ILLYRIAN GUARD SH.A.

- Shkresa e Shoqërisë “Illyrian Guard” ShA nr. 820/2, datë 23.05.2023 me lëndë “Kthim përgjigje shkresës nr.290 prot, datë 05.05.2023”,
- Shkresën e Drejtorisë Rrajonale OSSH-sha, Fier nr. 820/3, datë 30.05.2023 me lëndë “Kthim Përgjigje” ,,,.
- Shkresa e Shoqërisë “Illyrian Guard” ShA nr. 820/4, datë 02.06.2023 me lëndë “Kthim përgjigje shkresës nr.290/2 prot, datë 25.05.2023...”,
- Shkresën e Drejtorisë Rrajonale OSSH-sha, Fier nr. 820/5, datë 19.06.2023 me lëndë “Kthim Përgjigje shkresës nr.820/4 prot, datë 02.06.2023....”.

### VENDOSI:

1. Shoqëria “Illyrian Guard” ShA të shprehë pamundësinë e ofrimit të shërbimit të sigurisë 1.3.A për objektet e “Drejtorisë Rrajonale OSSH-sha, Fier”, brenda fondit të subjektit **89,555,508** lekë pa TVSH për 12 muaj.
2. Shoqëria të bëjë me dije subjektin se “Illyrian Guard” ShA shpreh mundësinë e ofrimit të shërbimit 1.3.A të sigurisë për subjektin në çdo kohë, me fond **113,239,099** lek pa TVSH për 12 muaj me 79.06 punonjës shërbimi dhe 25 sisteme elektronike dhe se subjekti duhet të shtojë në Dokumentat Standarte të Tenderit fjalinë “Kjo marrëveshje kuadër dhe çdo minikontratë e lidhur me subjektin privat të shërbimit të sigurisë do të konsiderohet e zgjidhur nëse Shoqëria “Illyrian Guard” ShA shpreh mundësinë e ofrimit të shërbimit të sigurisë”.
3. Vendimi t’i dërgohet subjektit brenda tre ditëve nga dita e nesërme e protokollimit të vendimit të Shoqërisë “Illyrian Guard” ShA dhe për dijeni Agjencisë së Prokurimit Publik.

### KOMISIONI

1. Qamil Abedin Anëtar
2. Liridon Pula Kryetar
3. Gentjan Tarka Anëtar